

Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin kontraktues:

Emri:	<i>Fadil Nura</i>	Emri:	Haxhi Bejta
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ	Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Për Kontraktuesin: **Grup i Operatorëve Ekonomik**
N.N.P. Ndertimi; Haxha Kom SH.P.K.

Emri:	<i>ARMEND SINANI</i>
Pozita:	<i>i AUTORIZUAR</i>
Nënshkrimi:	
Data:	<i>19.06 2023</i>
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: **643-23-2581-5-1-1/C402**

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilitdo njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruarat che të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoritet Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuese në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

- 14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Purët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të fillojë punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është më vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dërguar Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të caktuar nga KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rreza dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agentit e tij, të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimin të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojnë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe vlerë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënë është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuar të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaceve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jenë kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë punë, ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqim të Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishmë, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **643-23-2581-5-1-1/C402**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veprojë konform Rregullores Nr.001/2022 dhe neneve 70.23 dhe 70.24 të kësaj rregullore ndërsa Mbikqyresi I drejtpërdrejt në bazë të nenit 70.25 të kësaj Rregulloreje. <i>Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ "ZKA".</i> <i>ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin (mbikqyrjen) e kontratës specifike dhe një mbikqyrës të drejtë përdrejtë të menaxherit të kontratës.</i> <i>Pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës.</i> <i>Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet të përgatisë dhe krijojë një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës".</i> <i>Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël.</i> <i>Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës.</i> <i>Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Kontratës nga ana e AK dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.</i> <i>Pas aprovimit dhe nënshkrimit të Planit për menaxhim të kontratës, i njëjti plan do të jetë në dispozicion për shkarkim nga ana e departamentit të prokurimit.</i> <i>Pasi Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit shkarkon dhe rishikon planin për menaxhimin e kontratës, Menaxheri i Kontratës do t'i lëshojë Operatorit Ekonomik:</i> <i>a. Letrën e fillimit të punëve, në rastin e kontratës për punë;</i> <i>- Menaxheri i Projektit do të:</i> <i>(a) Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;</i> <i>(b) sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje</i>

		me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë dhe c) Bëj vlerësimin e përformancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij. - Funksionet e Menaxherit të Projektit janë: a) Të sigurojë që operatori ekonomik i përbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; b) Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; c) Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; d) Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme; e) Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës; f) Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgaditen, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik; g) Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; h) T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin; i) Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit; j) Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe k) T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA. Fërgjegjësitë e Mbikqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës Mbikqyrësit i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për: a) mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të implementimit të kontratës; b) administrimin e plotë të kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual në kontratë; dhe c) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Kontraktuesi duhet t'i respektojë che të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës. - Do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rëndë dakord mes palëve kontraktuese; - Do të sigurojë për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara; - Duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës në qoftë se për kryerjen e punëve duhet të përdoren pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të

		llojeve të ndryshme, skela të larta etj varesisht nga natyra e këtij aktivitetit të prokurimit.OE duhet të siguroj mjetet e domosdoshme për punë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj; -Do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim; - Do të sigurojë sigurinë në Vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit -do të mbajë një regjistër të punëve në rast të kontratave për punë. <i>(iii)Përpos sigurisë në nenet e larëpërmendura të kësaj kontrate parashihet edhe mbrojtja e shëndetit të punëtorëve të kontraktuesit: ku do të zbatohen dispozitat pozitive të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin e punëtorëve në punë në fuqi dhe nese vjen deri të ndonjë rast do të zbatohen dispozitat e këtij Ligji respektivisht Neni 8 par.4. dhe çdo dispozitë e këtij ligji që ka të bëjë me mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve dhe në rast se ndodh rasti përgjegjësi e mban kontraktuesi dhe nënkontraktuesi</i>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës, në kohëzgjatje prej 37 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës, Operatori i cili do të shpërblehet me Kontratë është i obliguar që këtë siguri ta dorëzoj në mënyrë fizikë në zyrën e Prokurimit para nënshkrimit të Kontratës
Përgjegjësia dhe i Sigurimi Kontraktuesit	11.2	Sipas ligjeve në fuqi.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <i>[shëno numrin]</i> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Punimet fillojnë me datën e urdhërësës së Letres për fillimin e punimeve në formë elektronike, në e-mail zyrtar apo në formë fizike nga Menaxheri i Kontratës, i emëruar me vendim të ZKA-së; Data e fillimit do të jetë sipas Planit të Menaxhimit të Kontrates, pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punën.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 480 ditë pune jo kalendarike me ditat e punës, të nxjerr nga

		menaxheri i kontratës/organi mbikëqyrës brenda viteve 2023 – 2024 - 2025, -Pranimin i punëve , bëhet nga Komisioni në përbërje të plotë prej tre (3) apo (5) anëtarësh të emëruar me vendim të caktuar , me Ligjin - Rregulloret në fuqi.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.05 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Në vend punishte duhet të mbahet ditar dhe libri ndërtimor, Kontraktuesi– Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Kontrates/Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Librin e Punës dhe Librin Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e punimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekt – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, kushtet e mctit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti të reshurat atmosferike, rrethanat e paparashikuara aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatja e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve
Pagesat		Pagesat do të bëhen në Euro. Konform Ligjit për menaxhimin e Financave Publike në Republikën e Kosovës. Autoriteti Kontraktues do ta paguaj Kontraktuesit, shumën e certifikuar për punët (situacionet) e përfunduara nga menaxheri i projektit – kontratës, dhe raportit të leshura nga ana e tij, brenda 30 ditëve nga data e çdo raporti për punët (situacionet) e përfunduara; Vërtetimi i pagesës nënshkruhet nga Menaxheri i Kontratës Pagesat do të bëhen në llogarinë bankare të Kontraktuesit sipas formularit të dorëzuar të identifikimit financiar për llogarinë bankare para nënshkrimit të kontratës, apo nëse kemi ndryshim të llogarisë bankare nga Kontraktuesi, sipas identifikimit për llogarinë bankare të dorëzuar gjatë realizimit të kontratës; • Drejtoria e Financave/Ministria përkatëse e ngarkuar me pagesat, duhet të informojë Menaxherin e Kontratës për pagesat në mënyrë që ta përfshijë atë në evidencën e dëshmive të realizimit të kontratës; • Pagesat për pranimet e fazave, Pranimet e Përkohshme dhe Përfundimtare duhet të realizohet vetëm pasi obligimet në bazë të kontratës janë realizuar dhe janë aprovuar/pranuar nga

		zyrtarët përgjegjës të AK. (Menaxheri i Kontratës, komisioni i pranimit); Shuma totale e pagesave nuk duhet të tejkalojë vlerën e kontratës, me përjashtim të rasteve kur gjatë realizimit ka ndryshime ligjore që mund të ndryshojnë taksat dhe tatimin.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Kontrates/projektit nga AK-Skenderaj, rezervon të drejtën ligjore që në çdo kohë të beje verifikimin e cilësisë së materialit/punëve në vend punishte drejtpërdrejtë. Menaxheri i Kontrates/ Projektit, gjatë pranimit të përkohshëm nëse konstatojnë se ka defekte do të lajmërohet menjëherë Kontraktuesin, që të bëjë korrigjimin e defekteve të tilla, deri të pranimit të përgjithshëm – pranimit dorëzimit të objektit. Kontraktuesi përmirësimin dhe riparimin e defekteve e bënë në kuadër të shpenzimeve të tij.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Ndërsa Pagesa për situacionin e fundit të certifikuar nga menaxheri i kontratës / organi mbikëqyrës i punëve do të bëhet me dorëzimin e garancionet nga OE. Punë kryesi i objektit, në vlerë 10%, të kontratës së përgjithshme, ku ky garancion do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, në kohëzgjatje prej 24 muaj, pas pranimit- dorëzimit të punëve; Pagesat do të bëhen nga Autoriteti Kontraktues, me plotësimin e dokumentacionit të lart cekur dhe faturën origjinale të Kontraktuesit me numrin e xhirollogarisë bankare.
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas planit dinamik nga nënshkrimi i kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuëse e defekteve do të jetë 24 muaj. Kontraktuesi është i obliguar që sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues në kohën e periudhës së garantimit. Operatori Ekonomik, Kontraktuesi i Punimeve duhet ta dorëzojë shtetërisht përgjithshme, ku ky garancion do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, pas pranimit dorëzimit përfundimtar të punëve. Ky garancion i ekzekutimit duhet të jetë nga një Kompani Sigurimi të caktuar nga Autoriteti Kontraktues. Sigurimi i ekzekutimit për garancionin e punëve – objektit të përfundimit të punëve të fundit. Nëse Kontraktuesi nuk i përgjigjet kërkesës me shkrim nga ana e Menaxherit të Kontratës përmes AK, mund të angazhojë një kompani të tjetër Kontraktuesit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme. Nëse me fajin e OE vjen deri të shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje të palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe

		pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhen mjete nga ana e Autoritetit Kontraktues për purët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhagitjen e punimeve që i paguan punë kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale të kontratës nga ana e Komunes së Skenderajt.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve në mes të dy palëve</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndërmjet palëve do të dorëzohet tek <i>[Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti Ekonomik]</i>.



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **114391**

Për **Kuvendi Komunal Skenderaj**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Ndertimi B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **017-Punimi i rrjetit të Ujësllësit në BL- Qirez**

Nr. prokurimit: 643-23-2581-5-1-1 , Nr. brendshëm: 017

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t' i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **161,623.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **161,623.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1147 ditë kalendarike prej **19.06.2023** deri më **09.08.2026**

Data lëshimit: 18.06.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni



Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr.19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **114391**

Kontraktuesi	
Emri	Ndertimi B.I.
Përfaqësuar nga	Safet Sinani
Adresa	Baksi
Nr i Biznesit	811401009
Telefoni	044214550

Përfituesi	
Emri	Kuvendi Komunal Skenderaj
Adresa	18 Qershori

Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka	NLB
Garantuesit	

Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	161,623.00
Periudha Sigurimit	19.06.2023 - 09.08.2026
Primi	8,474.58
Tvsh	1,525.42
Primi Bruto	10,000.00
Data e lëshimit	18.06.2023 17:47

Aktiviteti Ekonomik:
017-Punimi i rrjetit të Ujësjellësit në BL- Qirez

Lënda e Garancisë	
Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:	
1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.	
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.	
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).	
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.	
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)	

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Bedredin Pillana - 2436



Përfaqësuesi i të siguarit
Safet Sinani



PUNIMI I RRJETIT TË UJESJELLESIT NE BL QIREZË					
POS.	PËRSHKRIM	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI /NJËSIA - €	ÇMIMI TOTALI - €
1	Puna e demolimit				
1.1.	Montimi i ndërmjetes për të futur punimet ne projekt. Çmimi i koston i llogaritur ne hartimin e planit dhe programit të punës si dhe të gjithë koston së transportit dhe vendosjes së makinerive dhe personelit të punës.	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
1.2	Fiksimi i pikave të kontrollit gjeodezik dhe sigurimi i standardeve të gjendjes fizike të rrjetit. Shkelja në korsi gjeodezike të llogaritura me çmim ku do të kalojë furnizimi me ujë dhe transmetimi i punimeve me instrument gjeodezik.	m'	72000.00	0.25 €	18,000.00 €
1.3	Kontrolli dhe regjistrimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve të mundshme që lidhen me planin operativ të ndërtimit dhe hartimi i një plani operacional të detajuar që lidhet me procesin e ndërtimit. Çmimi i llogaritur mbi koston eventuale të pajisjeve elektronike për zbulimin e instalimeve elektrike nëntokësore dhe identifikimin e saktë të instalimeve që do të mirëmbahen gjatë ndërtimit (rrjeti, rrjeti telefonik i brendshëm, etj.)	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
1.4	Prishja e kubzave të trotuareve për vendosjen e tubacionit të ujësjesjesit. Çmimi përfshin ricilesimin e tyre me të gjitha elementet e nevojshme.	m'	3600.00	4.00 €	14,400.00 €
			TOTALI 1:		35,400.00 €
2	Puna toldësore				
2.1	Gërmim për hapjen e kanaleve, kategoria e terenit III-te deri kat. - VII me makineri perkatese si dhe thyerjes me qekanin perkates te materialeve nga guri, thellesi min. H = 1.2m sipas normave dhe standardeve.	m³	86400.00	0.60 €	51,840.00 €
2.2	Planifikimi i pjesës së poshtme të kanalit me saktësi deri në ± 1 cm.	m'	72000.00	0.40 €	28,800.00 €
2.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorrit në fund të kanalit dhe në anën e tubit dhe ngjeshja në shtresa deri në 20 cm kuotë toke.	m³	14450.00	4.50 €	65,025.00 €
2.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës 0-31.5 t = 10cm dhe 0-63mm t=20 cm për të mbuluar shtresën e fundit të kanalit dhe ngjeshja për rehabilitimin e rrugëve të demtuara.	m³	732.00	12.00 €	8,784.00 €
2.5	Mbushja dhe planifikimi i kanalit me material të gërmuar.	m³	77850.00	0.20 €	15,570.00 €
2.6	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar në landfillin e qytetit ose në vendin ku organi mbikëqyrës i caktuar nga L. = 5km	m³	8550.00	1.00 €	8,550.00 €
2.7	Gjerësia e prerjes së asfaltit b ndërmjet. 0.8 Vendosja e tubacionit të ujësjesjesit. Çmimi përfshin vendosjen e zhavorrit 0-16 mm; t = 1.5 cm dhe riasfaltimi t=7 cm	m²	1250.00	9.00 €	11,250.00 €
2.8	Gjerësia e prerjes së betonit b ndërmjet. 0.8 Vendosja e tubacionit të ujësjesjesit. Çmimi përfshin vendosjen e zhavorrit 0-16 mm; t = 1.5 cm si dhe ribetonim 10 cm	m²	670.00	4.00 €	2,680.00 €
2.9	Kalimi i rrugës përmes shpimit me makineri peraktese nën pjesën e caktuar të punës. Çmimi përfshin mbrojtjen nga tubi i çelikut për tubin PE 100 RC Ø40 deri Ø180 dhe dy pusetave në të dy anët e rrugës.	m'	150.00	120.00 €	18,000.00 €
2.10	Kalimi i rrugës nën pjesën e caktuar të punës. Çmimi përfshin mbrojtjen nga tubi i çelikut për tubin PE 100 RC Ø40 deri Ø180 dhe dy pusetave në të dy anët e rrugës.	m'	1150.00	3.00 €	3,450.00 €
2.11	Kalimi i rrjedhës nga pjesa e caktuar e punës. Çmimi përfshin mbrojtjen e tubit të çelikut me izolim mbështjellës për tubin e ujësjesjesit PE 100 RC Ø40 deri Ø180	m'	95.00	120.00 €	11,400.00 €
			TOTALI 2:		225,349.00 €
3	Punime betoni dhe armature				
3.2	Ndërtimi i pusetave të degëzimit sipas planeve ekzekutive me përmasa 2.5m * 2.0m * 1.8m. Dimensionet dhe gjeometria e gropave për t'u përshtatur instalimit të pjesëve lidhëse. Llogaritur mbi çmimin e të gjitha punimeve të nevojshme si (Gërmim, izolim, Kallep, betonim të kapakut metalik me afësi mbajtëse 40 ton dhe të gjitha punimet e kërkuara sipas kushteve teknike) dhe pjesës së punës të dhënë.	copë	5.00	300.00 €	1,500.00 €
3.3	Ndërtimi i pusetave të degëzimit sipas planeve ekzekutive me përmasa 2.0m * 2.0m * 1.8m. Dimensionet dhe gjeometria e gropave për t'u përshtatur instalimit të pjesëve lidhëse. Llogaritur mbi çmimin e të gjitha punimeve të nevojshme si (Gërmim, izolim, Kallep, betonim i kapakut metalik me afësi mbajtëse 40 ton dhe të gjitha punimet e kërkuara sipas kushteve teknike) dhe pjesës së dhënë.	copë	5.00	250.00 €	1,250.00 €
3.4	Ndërtimi i pusetave të degëzimit sipas planeve ekzekutive me përmasa 1.5 m * 1.5 m * 1.7 m. Dimensionet dhe gjeometria e gropave për t'u përshtatur instalimit të pjesëve lidhëse. Llogaritur mbi çmimin e të gjitha punimeve të nevojshme si (Gërmim, izolim, Kallep, betonim i kapakut metalik me afësi mbajtëse 40 ton dhe të gjitha punimet e kërkuara sipas kushteve teknike) dhe pjesës së dhënë.	copë	6.00	200.00 €	1,200.00 €
3.7	Ndërtimi i aeratorëve të pusetave, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe montimi i valvulës së ventilimit, tipi me 3 funksione për çlirimin e ajrit gjatë mbushjes së tubit, gjatë funksionimit dhe gjatë shkarkimit (kullimit). Madhësitë e valvulave DN 80 mm në tuba 250 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton (DN 80) Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	3.00	250.00 €	750.00 €
3.8	Ndërtimi i aeratorëve të pusetave, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe montimi i valvulës së ventilimit, tipi me 3 funksione për çlirimin e ajrit gjatë mbushjes së tubit, gjatë funksionimit dhe gjatë shkarkimit (kullimit). Përmasat e valvulave DN 80 mm në tuba 250 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton (DN 80) Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	3.00	250.00 €	750.00 €
3.9	Ndërtimi i aeratorëve të pusetave, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe montimi i valvulës së ventilimit, tipi me 3 funksione për çlirimin e ajrit gjatë mbushjes së tubit, gjatë funksionimit dhe gjatë shkarkimit (kullimit). Madhësitë e valvulave DN 80 mm në tuba 150 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton (DN 80) Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	2.00	250.00 €	500.00 €
3.10	Ndërtimi i aeratorëve të pusetave, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe montimi i valvulës së ventilimit, tipi me 3 funksione për çlirimin e ajrit gjatë mbushjes së tubit, gjatë funksionimit dhe gjatë shkarkimit (kullimit). Madhësitë e valvulave DN 80 mm në tuba 125 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton (DN 80) Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	2.00	250.00 €	500.00 €

3.11	Ndërtimi i pusetave leshuse, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe montimi i valvulës së ventilimit, tipi me 3 funksione për çlirimin e ajrit gjatë mbushjes së tubit, gjatë funksionimit dhe gjatë shkarkimit (kullimit). Përmasat e valvulave DN 80 mm në tuba 250 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton (DN 80) Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	2.00	250.00 €	500.00 €
3.12	Ndërtimi i pusetave leshuse, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe vendosja e lirim të valvulave - Përmasat e valvulave DN 80 mm në tuba 125 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Në çmim të llogaritura të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me për ngarkesa mbajtëse 40 ton (DN 80) Sipas pjesës së punës. të dhëna	copë	2.00	250.00 €	500.00 €
3.13	Lëshimi Ndërtimi i pusetave, sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe vendosja e lirim të valvulave - Përmasat e valvulave DN 80 mm në tuba 90 mm (PN 10 bar dhe 16 bar) Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton (DN 80) Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	2.00	250.00 €	500.00 €
3.14	Ndërtimi i puseve për hidrantin nëntokësor të dhënë nga pjesa e punës. Hidrante nëntokësore DN80 me të gjitha pjesët që i nevojiten pjesës së dhënë, në çmim duhet të përfshihet kapak metalik me kushineta topash 40 ton	copë	5.00	250.00 €	1,250.00 €
3.15	Furnizimi dhe vendosja e punimeve të betonit për forcimin e tubave horizontale dhe vertikale sipas detajeve të projektit.	m³	30.00	80.00 €	2,400.00 €
3.16	Furnizimi dhe vendosja e blloqeve të betonit punojnë për stabilizimin e montimeve në puseta.	m³	6.00	85.00 €	510.00 €
			gjithsej 3:		12,110.00 €
4	Punimet e montimit dhe montimit				
Furnizimi, Transporti dhe Montimi i Gypave HDPE 100 RC me saldim ballor.					
4.1	RC TIP 2(10/75), Ø180 /PN 16 bar.	m'	22000.00	36.00 €	792,000.00 €
4.2	RC TIP 2(10/75), Ø180 /PN 10 bar.	m'	1000.00	21.00 €	21,000.00 €
4.3	RC TIP 2(10/75), Ø160 /PN 10 bar.	m'	1500.00	20.00 €	30,000.00 €
4.4	RC TIP 2(10/75), Ø125 /PN 16 bar.	m'	1300.00	19.00 €	24,700.00 €
4.5	RC TIP 2(10/75), Ø125 /PN 10 bar.	m'	650.00	13.00 €	8,450.00 €
4.6	RC TIP 2(10/75), Ø110 /PN 16 bar.	m'	500.00	14.00 €	7,000.00 €
4.7	RC TIP 2(10/75), Ø110 /PN 10 bar.	m'	2900.00	12.00 €	34,800.00 €
4.8	RC TIP 2(10/75), Ø90 /PN 16 bar.	m'	1300.00	12.00 €	15,600.00 €
4.9	RC TIP 2(10/75), Ø90 /PN 10 bar.	m'	3000.00	10.00 €	30,000.00 €
4.10	RC TIP 2(10/75), Ø75 /PN 16 bar.	m'	2000.00	9.00 €	18,000.00 €
4.11	RC TIP 2(10/75), Ø75 /PN 10 bar.	m'	15500.00	8.60 €	133,300.00 €
4.12	RC TIP 2(10/75), Ø63 /PN 16 bar.	m'	800.00	8.40 €	6,720.00 €
4.13	RC TIP 2(10/75), Ø63 /PN 10 bar.	m'	10500.00	8.10 €	85,050.00 €
4.14	RC TIP 2(10/75), Ø50 /PN 10 bar.	m'	5100.00	8.00 €	40,800.00 €
4.15	RC TIP 2(10/75), Ø40 /PN 10 bar.	m'	3950.00	7.00 €	27,650.00 €
4.16	Transporti i furnizimit dhe vendosja e shiritit zbulues -sinjalizues mbi tubacionin e ujësjellësit (sipas kushteve në specifikimet teknike P.5.16.8).	m'	72000.00	0.30 €	21,600.00 €
			gjithsej 4:		1,296,670.00 €
5	Pajisjet				
SHËNIM: valvulat dhe pajisjet duhet të jenë në përputhje me standardin DIN EN ISO 9000-2000 dhe duhet të jenë të certifikuar sipas testeve DIN-DVGW. Të gjitha pjesët duhet të mbrohen nga korrozioni përmes veshjes me treshirë epoksi (min. 250 µm), e cila duhet të jetë në përputhje me DIN 3476 (P) dhe DIN 30 677 Pjesa 2. Të gjitha valvulat dhe pajisjet prej hekuri duhet të prodhohen për pije ujë. Tubat fittingu dhe HDPE nga granda PE 100 + duhet të jenë në përputhje me standardet EN ISO 9001: 2000 dhe EN ISO 14001: 2004 (1996), DVGW, DVS, BGR 500 (VBO 50). Filarsia e montimit të valvulës dhe sonda duhet të jenë sipas DIN EN 1092-2 Pjesa 2. Presioni i funksionimit: 10 & 16 bar. Pjesë shtesë (bulona, unaza lidhëse, etj.) për lidhje duhet të përfshihen në të gjitha pozicionet.					
5.1	Tee DN - 180/180/180 mm	copë	3.00	45.00 €	135.00 €
5.2	Tee DN - 180/180/180 mm	copë	4.00	45.00 €	180.00 €
5.3	Tee DN - 150/150/150 mm	copë	5.00	30.00 €	150.00 €
5.4	Tee DN - 125/125/125 mm	copë	4.00	25.00 €	100.00 €
5.5	Tee DN - 100/100/100 mm	copë	15.00	20.00 €	300.00 €
5.6	Tee DN - 80/80/80mm	copë	10.00	15.00 €	150.00 €
5.7	Valvula e portës DN - 180 mm	copë	3.00	85.00 €	255.00 €
5.8	Valvula e portës DN - 180 mm	copë	4.00	80.00 €	320.00 €
5.9	Valvula e portës DN - 150 mm	copë	8.00	55.00 €	440.00 €
5.10	Valvula e portës DN - 125 mm	copë	4.00	50.00 €	200.00 €
5.11	Valvula e portës DN - 100 mm	copë	15.00	35.00 €	525.00 €
5.12	Valvula e portës DN - 80 mm	copë	10.00	30.00 €	300.00 €
5.13	Valvula e portës DN - 65 mm	copë	22.00	25.00 €	550.00 €
5.14	Valvula e portës DN - 50 mm	copë	30.00	20.00 €	600.00 €
5.15	Kompensuesi DN - 180 mm	copë	3.00	85.00 €	255.00 €
5.16	Kompensuesi DN - 150 mm	copë	4.00	35.00 €	140.00 €
5.17	Kompensuesi DN - 125 mm	copë	5.00	30.00 €	150.00 €
5.18	Kompensuesi DN - 100 mm	copë	5.00	30.00 €	150.00 €
5.19	Kompensuesi DN - 80 mm	copë	15.00	25.00 €	375.00 €
5.20	Kompensuesi DN - 65 mm	copë	10.00	20.00 €	200.00 €
5.21	Kompensuesi DN - 50 mm	copë	22.00	20.00 €	440.00 €
5.22	FF copa DN - 180/500 mm	copë	3.00	35.00 €	105.00 €
5.23	FF copa DN - 180/800 mm	copë	4.00	30.00 €	120.00 €
5.24	FF copa DN - 150/800 mm	copë	8.00	35.00 €	280.00 €
5.25	FF copa DN - 150/500 mm	copë	4.00	30.00 €	120.00 €
5.26	FF copa DN - 125/800 mm	copë	4.00	30.00 €	120.00 €
5.27	FF copa DN - 125/500 mm	copë	3.00	25.00 €	75.00 €
5.28	FF copa DN - 100/800 mm	copë	5.00	25.00 €	125.00 €
5.29	FF copa DN - 100/500 mm	copë	4.00	20.00 €	80.00 €
5.30	FF copa DN - 80/800 mm	copë	4.00	20.00 €	80.00 €

5.31	FF copa DN - 80/500 mm	copë	5.00	15.00 €	75.00 €
5.32	FF copa DN - 65/800 mm	copë	5.00	15.00 €	75.00 €
5.33	FF copa DN - 65/500 mm	copë	5.00	20.00 €	100.00 €
5.34	FF copa DN - 50/800 mm	copë	4.00	20.00 €	80.00 €
5.35	FF copa DN - 50/500 mm	copë	5.00	20.00 €	100.00 €
5.36	Fllanxa e përshtatësit 180mm	copë	3.00	25.00 €	75.00 €
5.37	Fllanxa e përshtatësit 150 mm	copë	10.00	20.00 €	200.00 €
5.38	Fllanxa e përshtatësit 125 mm	copë	5.00	15.00 €	75.00 €
5.39	Fllanxa e përshtatësit 100 mm	copë	7.00	15.00 €	105.00 €
5.40	Fllanxa e përshtatësit 80 mm	copë	15.00	15.00 €	225.00 €
5.41	Fllanxa e përshtatësit 75 mm	copë	30.00	15.00 €	450.00 €
5.42	Fllanxa e përshtatësit 63 mm	copë	50.00	13.00 €	650.00 €
5.43	Fllanxa e përshtatësit 50 mm	copë	40.00	12.00 €	480.00 €
5.44	Fllanxa e përshtatësit 40 mm	copë	30.00	12.00 €	360.00 €
5.45	PRV - 150 DN	copë	3.00	85.00 €	255.00 €
5.46	PRV - 100 DN	copë	5.00	60.00 €	300.00 €
5.47	PRV - DN 80	copë	5.00	50.00 €	250.00 €
5.48	PRV - DN 65	copë	7.00	35.00 €	245.00 €
5.49	PRV - 50 DN	copë	3.00	35.00 €	105.00 €
5.50	Reduktues FFR DN - 180 / 150 mm	copë	3.00	32.00 €	96.00 €
5.51	Reduktues FFR DN - 150 /125 mm	copë	2.00	85.00 €	170.00 €
5.52	Reduktues FFR DN - 150 /100 mm	copë	3.00	31.00 €	93.00 €
5.53	Reduktues FFR DN - 150 /80 mm	copë	4.00	31.00 €	124.00 €
5.54	Reduktues FFR DN - 150 /65 mm	copë	4.00	30.00 €	120.00 €
5.55	Reduktues FFR DN - 125 /100 mm	copë	1.00	25.00 €	25.00 €
5.56	Reduktues FFR DN - 125 /80 mm	copë	3.00	20.00 €	60.00 €
5.57	Reduktues FFR DN - 125 /50 mm	copë	1.00	20.00 €	20.00 €
5.58	Reduktues FFR DN - 100/ 80 mm	copë	4.00	15.00 €	60.00 €
5.59	Reduktues FFR DN - 100 / 65 mm	copë	7.00	15.00 €	105.00 €
5.60	Reduktues FFR DN - 100/ 50 mm	copë	7.00	12.00 €	84.00 €
5.61	Reduktues FFR DN - 100/ 40 mm	copë	12.00	12.00 €	144.00 €
5.62	Reduktues FFR DN - 80/ 65 mm	copë	18.00	12.00 €	216.00 €
5.63	Reduktues FFR DN - 80/ 50 mm	copë	14.00	12.00 €	168.00 €
5.64	Kapaku fundor Ø 50mm	copë	4.00	20.00 €	80.00 €
5.65	Reduktues FFR DN - 65/ 50 mm	copë	30.00	12.00 €	360.00 €
5.66	Reduktues FFR DN - 65/ 40 mm	copë	28.00	12.00 €	336.00 €
5.67	Ndërtimi i pusetave sipas detajeve të dhëna. Sigurimi dhe montimi i teleskopit, Çmimi i llogaritur të gjitha pjesët lidhëse dhe kapakun metalik me kushineta topash 40 ton Sipas të dhënave të pjesës së punës	copë	55.00	25.00 €	1,375.00 €
5.68	furnizimi i transportit dhe montimi i valvulës teleskopike sipas detalit të dhënë me të gjitha pjesët e nevojshme	copë	55.00	25.00 €	1,375.00 €
5.69	Kapaku fundor Ø 40 mm	copë	25.00	10.00 €	250.00 €
5.70	Kapaku fundor Ø 50 mm	copë	20.00	12.00 €	240.00 €
5.71	Kapaku fundor Ø 63 mm	copë	15.00	15.00 €	225.00 €
5.72	Kapaku fundor Ø 75 mm	copë	8.00	20.00 €	160.00 €
5.73	Kapaku fundor DN 80 mm	copë	5.00	15.00 €	75.00 €
5.74	Kapaku fundor DN 100 mm	copë	4.00	20.00 €	80.00 €
5.124	Kapaku fundor Ø 200 mm	copë	1.00	25.00 €	25.00 €
Transporti i furnizimit dhe instalimi i matësve të ujit të pajisur me modulun Zona AMR - GPRS. Prodhuesi i njehsorit duhet të ketë certifikata të vlefshme nga Instituti i njohur ndërkombëtar: ISO 9001, ISO 14001, ISO 18001, MID - EC 2004/22 / EC ose miratimin evropian - Klasa B, mbrojtje IP68. • Jetëgjatësia e baterisë me bateri min. 10 vjet, duke marrë parasysh 2 lexime në ditë.					
5.75	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të matësve të ujit, tubi DN - 75 mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	5.00	310.00 €	1,550.00 €
5.76	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të ujëmatësit sipër, tub DN - 80mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	2.00	320.00 €	640.00 €
5.77	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të matësve të ujit, tubi DN -100mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	2.00	330.00 €	660.00 €
5.78	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të matësve të ujit, tubi DN - 125 mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	5.00	340.00 €	1,700.00 €
5.79	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të matësve të ujit, tubi DN150mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	4.00	350.00 €	1,400.00 €
5.80	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të ujëmatësit sipër, tubi Ø 200mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	1.00	360.00 €	360.00 €
5.80	Ndërtimi i pusetave dhe veçorive të instalimit të ujëmatësit sipër, tub DN - 200mm. Në çmim janë parashikuar të gjitha punimet e nevojshme sipas të dhënave të pjesës së punës dhe specifikimeve teknike	copë	2.00	360.00 €	720.00 €
gjithsej 5:				24,321.00 €	
6	Punime të tjera				
6.1	Pompa e shkarkimit të ujit, gjatë punimeve.	orë	30.00	2.00 €	60.00 €
6.2	Testimi i tubit PE 100 siç përshkruhet në përputhje me kërkesat teknike.	m'	72000.00	0.10 €	7,200.00 €
6.3	Dezinfektimi i tubit PE 100 siç përcaktohet në përputhje me kërkesat teknike.	m'	72000.00	0.01 €	720.00 €
6.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për punimet dhe dorëzimi tek investitori i realizuar në tre kopje	m'	72000.00	0.20 €	14,400.00 €
gjithsej 6:				22,380.00 €	
RIKAPITULLIM					

1	Puna e demolimit	35,400.00 €
2	Puna tokësore	225,349.00 €
3	Punime betoni dhe armature	12,110.00 €
4	Puna e instalimit	1,296,670.00 €
5	Pajisjet	24,321.00 €
6	Punë të tjera	22,380.00 €
Total:		1,616,230.00 €

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE:	N.N.P "NDËRTIMI"
EMRI DHE MBIEMRI I PEFAQESUESIT TE OE:	SAFET SINANI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	15.05.2023
VULA:	

